

NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Universiteti Bujqësor i Tiranës nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it

Nëpërmjet një marrëveshje të firmosur sot nga Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Drejtoreshës së Agjencisë Kombëtare të Cannabis-it, Prof. Ass Linda Pustina, Universiteti Bujqësor i Tiranës vazhdon të zgjerojë fushat e bashkëpunimit me aktorë dhe agjenci të rëndësishme në vend. Ndër shumë aktivitete të tjera, në këtë Marrëveshje UBT merr përsipër të kontribuojë në fushën e këshillimit, hartimin e strategjive, manualeve, udhëzimeve dhe aspekteve teknike mbi rregulloret në fushën e kontrollit, kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore e industriale. Aspekt shumë i rëndësishëm i kësaj Marrëveshjeje është fuqizimi dhe vendosja në dispozicion e laboratorit shkencor të UBT-së për kryerjen e analizave kimike dhe studimeve shkencore të përbashkëta apo në kuadër të projekteve të ndryshme.

**MË TË LEXUAR:****WEB**

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BLOG/UNIVERSITETI-13/KONSTITUOHET-DHE-FILLON-PUNE-KOMISIONI-I-PERBASHKET-I-STUDIMEVE-DHE-KURIKULAVE-STUDY-CURRICULA-COMMISION-SCC-NE-UBT-667](https://www.ubt.edu.al/sq/blog/universiteti-13/konstituohet-dhe-fillon-pune-komisioni-i-perbashket-i-studimeve-dhe-kurikulave-study-curricula-commision-scc-ne-ubt-667)

UBREEN**Follow us:**

UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS




UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



Takimi hapës për implementimin e Marrëveshjes mes UBT dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor

Konstituohet dhe fillon punë Komisioni i Përbashkët i Studimeve dhe Kurikulave (Study Curricula Commission, SCC) në UBT

Në kuadër të projektit UBT-BOKU 2030, më datë 16 Janar 2025, filloi punë Komisioni i Studimit dhe Kurikulës (SCC) në UBT, anëtarët e të cilit u zgjodhën pas një procesi të hapur aplikimi dhe më pas votimi nga Senati Akademik i UBT më datë 6 Dhjetor 2024. Ky komision përfaqëson një hap transformues në zhvillimin e programeve mësimore dhe kurrikulave në UBT për periudhën në vazhdim, duke siguruar përputhjen me standardet dhe modelin e BOKU. Kjo iniciativë siguron që, duke filluar nga viti ardhshëm akademik, UBT-ja do të ofrojë programe studimi ndërdisiplinore me cilësi të lartë të përafuara me universitetet e tjera në vendet e BE-së.



UBT në partneritet me Agjencinë Kombëtare të Pyjeve lançon projektin: "Hartimi i një modeli menaxhimi për luftimin e dëmtuesit të procesionares së pishës"

Fokusi i projektit është luftimi i këtij dëmtuesi në pyjet e Shqipërisë, duke angazhuar komunitetet lokale dhe të gjithë aktorët e interesuar për të rimëkëmbur ekosistemet pyjore. FSHP do të ofrojë njohuritë dhe ekspertizën e tij në hartimin e protokolleve operationale për kontrollin e procesionares, përdorimin dhe fuqizimin e Labororit qendror të Mbrotjtjes së Pyjeve në Fakultet, trajnimin e stafit të shërbimit pyjor pranë bashkive pjesëmarrëse, hartimin e metodave mekanike dhe biologjike të kombinuara që do të aplikohen në sipërfaqet pilot etj.



Universitetit Bujqësor i Tiranës dëshmon angazhimin dhe përkushtimin e tij në kuadër të projektit UBT-BOKU 2030

Komisioni i Studimit të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe grupet e punës për programet e mësimit, të miratuar nga Senati Akademik i UBT, zhvilluan një takim me drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore të Universitetit mbi modalitetet e konstituimit të grupeve të punës që do të punojnë për hartimin e ofertës së re akademike të UBT në kuadër të projektit UBT-BOKU 2030.

